

Analiza e Sondazhit Online të Performancës së Bashkisë Pukë për Vitin 2020

Rezultatet e sondazhit deri në datë 10 qershor 2021

Analiza është përgatitur nga Smart Processes

Hyrje

Çfarë është sondazhi i performancës?

Në kuadër të asistencës së ofruar nga projekti Bashkia e Fortës, Bashkia Pukë në bashkëpunim me kompaninë Smart Processes hartuan Raportin e Performancës për vitin 2020 të bashkisë. Raporti nuk zëvendëson raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, por është një dokument shoqëruar që ofron informacion të kuptueshëm financiar mbi mbledhjen dhe përdorimin e fondeve të bashkisë dhe shkon përtej duke paraqitur objektivat konkret të bashkisë për secilin funksion që ushtron (paraqitur përmes programeve buxhetore) dhe mundëson matjen e realizimit të objektivave përmes treguesve të performancës. Në këtë mënyrë, ky raport i hartuar në një gjuhë të kuptueshme për aktorë të rëndësishëm të bashkisë siç janë Këshilli Bashkiak, komuniteti vendor, media, organizata të ndryshme, akademikë etj., përdoret si një mjet për të monitoruar dhe matur performancën e funksioneve që realizon/financon bashkia si dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe është shndërruar tashmë në një proces të përvitshëm nga ana e bashkisë.

Duke realizuar një raport performance, bashkia synon të masë dhe raportojë sasinë dhe cilësinë e shërbimit në mënyrë të vazhdueshme (nga njëri vit në tjetrin). Në këtë mënyrë bashkia duke

ardhur me një gjuhë që flet me rezultate (tregues performance) nxit besim mes bashkisë dhe komunitetit, në këtë mënyrë ajo sjell më shumë transparencë dhe tregon përgjegjshmëri nga ana e saj.

Duke u nisur nga nevoja për përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në qeverisjen vendore, Këshilli Bashkiak e asistuar nga projekti Bashki të Forta hartoi këtë sondazh, i cili bazohet në rezultatet kyçe të raportit të performancës të vitit 2020. Sondazhi mundëson shfaqjen e këtyre rezultateve dhe mbledhjen e mendimeve të komunitetit të bashkisë mbi mënyrën sesi bashkia i ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2020 dhe të kuptojë prioritetet e komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2022-2024.

Pyetjet e sondazhit janë ngritur mbi të dhënat faktike të vitit 2020 në lidhje me peshën e buxhetit që ka harxhuar bashkia për shërbimet / funksionet kryesore që ofrohen, pyet komunitetin në lidhje me gadishmërinë e tij për të paguar më shumë tarifa për të përmirësuar apo rritur shërbimet që i ofrohen sot, si dhe mundëson vlerësimin e punës së kryetarit aktual të bashkisë.


Rezultatet e sondazhit

Të dhëna të përgjithshme

Pjesëmarrja e përgjithshme






Sondazhit i janë përgjigjur 68 persona, nga të cilët rreth 51.5%, ose 34 janë femra dhe 48.5%, ose 32 janë meshkuj. Është për t'u vlerësuar pjesëmarrja e lartë e femrave në këtë sondazh.


Rreth 56.7% e pjesëmarrësve deklarojnë se e kanë lexuar raportin e performancës për qytetarin dhe e kanë vlerësuar si të vlefshëm dhe të dobishëm informacionin që jep duke i vendosur notën 4 nga 5 maksimumi.



Përfaqësimi rezidencial

Pjesëmarrja sipas rezidencës në njësitë administrative të bashkisë është sipas tabelës së mëposhtme:





	Rezidenca	Femer	Mashkull	Pa Specifikuar	Total
	Pukë	25	13	0	38
	Gjegjan	1	2	1	4
	Rrapë	0	6	0	6
	Qelëz	6	7	0	13
	Qerret	2	3	0	5




Përfaqësimi rezidencial është gjithëpërfshirës, ku vërehet se dominon pjesëmarrja nga qyteti i Pukës me rreth 57.6% të pjesëmarrësve në sondazh. Pjesëmarrja më e ulët në sondazh është nga njësitë administrative Gjegjan.

Përfaqësimi sipas grup moshave

Vërehet se pjesëmarrësit në sondazh janë pothuajse sipas të gjitha grup moshave, ku dominon grup moshë 18-30 vjeç me 55.2%, e ndjekur nga grup moshë 31-45 vjeç me 34.3%. Në sondazh nuk ka marrë pjesë asnjë person mbi 60 vjeç. Në tabelën e mëposhtme paraqitet përfaqësimi sipas grup moshave.

	Grupmosha	Numër
	18-30 vjeç	37
	31-45 vjeç	23
	45-60 vjeç	7
	mbi 60 vjeç	0
	Total	67




Përfaqësimi sipas kategorive të punësimit/veprimtarisë në sektorin ekonomik të pjesëmarrësve

Opinionit përmes sondazhit është shprehur nga përfaqësues të aktiviteteve të ndryshme ekonomike, ku kryeson kategoria e studentëve me 25.4% ose 17 vetë. Numri më i ulët i pjesëmarrësve vjen nga persona që i përkasin kategorisë “Punonjës OJF/Akademik”, të cilët zënë 1.5% të totalit të pjesëmarrësve ose në shifra 1 person.

Shpërndarja sipas aktivitetit në sektorin ekonomik paraqitet në tabelën e mëposhtme, e ilustruar edhe me paraqitjen grafike të peshave që zenë ndaj totalit.

Kategoria	Numri i pjesëmarrësve
I vetë punësuar	13
I punësuar në sektorin privat	8
I punësuar në sektorin publik (administratë)	13
Punonjës OJF/Akademik	1
Student	17
I papunë	14
Tjetër	1
TOTAL	67



Analizimi i përgjigjeve mbi shërbimet më të financuara

Shpërndarja e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020

Për të kuptuar dakordësinë e pjesëmarrësve për mënyrën si janë shpenzuar paratë gjatë vitit 2020, në sondazh janë listuar programet që kanë zënë peshën më të madhe të buxhetit të shpenzuar në raport me totalin dhe secili pjesëmarrës shpreh mendimin e tij lidhur me dakordësinë për këtë shpërndarje për secilin shërbim.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten përgjigjet e pjesëmarrësve lidhur me dakordësinë e tyre për secilin shërbim (program buxhetor).

A jeni dakort me menyren si janë shpenzuar paratë?	Jam dakord		Duhet shpenzuar më shumë		Duhet shpenzuar më pak		Nuk e di	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
19% Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	49	72.1%	16	23.5%	1	1.5%	2	2.9%
13% Gjelbërimi, varrezat, trotuaret	45	66.2%	11	16.2%	9	13.2%	3	4.4%
12% Administrata e bashkisë	38	55.9%	8	11.8%	20	29.4%	2	2.9%
11% Arsimi bazë dhe parashkollor	37	54.4%	24	35.3%	2	2.9%	5	7.4%
10% Kujdesi social për familjet dhe fëmijët (përfshihet çerdhja)	43	63.2%	20	29.4%	4	5.9%	1	1.5%
8% Ujitja dhe kullimi	39	57.4%	15	22.1%	10	14.7%	4	5.9%
5% Arsimi i mesëm i përgjithshëm	43	63.2%	19	27.9%	5	7.4%	1	1.5%
4% Sporti dhe argëtimi	40	58.8%	21	30.9%	5	7.4%	2	2.9%
4% Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	41	60.3%	19	27.9%	4	5.9%	4	5.9%

Opinionin e shprehur në përqindje është ilustruar në grafikun e mëposhtëm:

A jeni dakort me menyrën si janë shpenzuar paratë? Shprehni opinionet tuaja në lidhje me këtë.



Siç vërehet të dhënat dhe nga grafiku, shërbimet për të cilat ka një kërkesë më të lartë për të shpenzuar më shumë janë:

- Arsimi bazë dhe parashkollor dhe
- Sport dhe argëtim

Vlerësimi i performancës së bashkisë në shërbimet më të financuara gjatë 2020

Për të kuptuar sesi e vlerëson komuniteti performancën e bashkisë në shërbimet më të financuara gjatë vitit 2020, në sondazh janë listuar programet që kanë zënë peshën më të madhe të buxhetit të shpenzuar në raport me totalin dhe secili pjesëmarrës shpreh mendimin e tij lidhur me performancën e bashkisë në ofrimin e këtyre shërbimeve.


Në tabelën e mëposhtme paraqiten përgjigjet e pjesëmarrësve lidhur me performancën për secilin shërbim të ofruar.

Si e vlerësoni performancën e bashkisë për shërbimet kryesore të ofruara?	Shumë mirë		Neutral		Jo mirë		Nuk e di	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	46	67.6%	7	10.3%	14	20.6%	1	1.5%
Gjelbërimi, varrezat, trotuaret	47	69.1%	14	20.6%	5	7.4%	2	2.9%
Administrata e bashkisë	41	61.2%	16	23.9%	9	13.4%	1	1.5%

Arsimi bazë dhe parashkollor	41	61.2%	16	23.9%	9	13.4%	1	1.5%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët (përfshihet çerdhja)	44	64.7%	16	23.5%	6	8.8%	2	2.9%
Ujitja dhe kullimi	39	57.4%	13	19.1%	13	19.1%	3	4.4%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	39	58.2%	17	25.4%	10	14.9%	1	1.5%
Sporti dhe argëtimi	39	57.4%	16	23.5%	10	14.7%	3	4.4%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	46	67.6%	15	22.1%	6	8.8%	1	1.5%

Opinionet e shprehura nga komuniteti është ilustruar në grafikun e mëposhtëm:

Si e vlerësoni performancën e bashkisë për shërbimet kryesore të ofruara?




Siç vërehet nga grafiku, komuniteti në përgjithësi e vlerëson performancën e bashkisë në të gjitha shërbimet më të financuara gjatë vitit 2020 si shumë të mirë. Vetëm 21% e pjesëmarrësve mendojnë se performanca e bashkisë në ofrimin e shërbimeve për kujdesin social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara, si jo të mirë, ndërsa 19% e vlerësojnë si jo të mirë performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimit të ujitjes dhe kullimit.

Analizimi i prioriteteve të komunitetit

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që sondazhi përpiqet të analizojë dhe të marrë mendimin e komunitetit ka të bëjë me prioritetet e komunitetit. Për të bërë këtë, merren në analizë funksionet / programet buxhetore për të cilat është shpenzuar më pak se 2% e buxhetit gjatë vitit 2020, si dhe mundësia për të përcaktuar vetë një prioritet, nëse ai nuk ndodhet në listë. Qëllimi është të

kuptohet se për cilat nga këto funksione komuniteti mendon se duhet të rritet pesha e shpenzimeve në raport me shpenzimet e përgjithshme të bashkisë. Ndaj, pjesëmarrësve i listohen në sondazh lista e funksioneve/programeve buxhetore të financuara nën 2% ose që nuk janë financuar nga bashkia dhe pjesëmarrësit zgjedhin 1 ose më shumë funksione nga kjo listë, duke shprehur në këtë mënyrë opinionin e tyre mbi funksionet që duhet të jenë në fokusin e bashkisë gjatë vitit 2022 dhe në planin afatmesëm të bashkisë 2022 – 2024.

Përgjigjet e pjesëmarrësve janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm:





Siç vërehet, sugjerimet kryesore të komunitetit janë për të priorizuar shërbimin e pastrimit, mbështetjen për zhvillim ekonomik. Gjithashtu 27 persona kanë kërkuar që shërbimet bujqësore, rrjeti rrugor dhe turizmi të jenë shërbime prioritare për bashkinë.

Gjithashtu, komuniteti ka patur mundësi të shprehë edhe opinionin e tij, dhe bie në sy që 8 persona kanë kërkuar specifikisht ndërtimin e një ure automobilistike që do të mundësojë aksesimin e pikes turistike Maja e Murgës.

Rëndësia për të informuar komunitetin

Sondazhi ofron mundësinë që pjesëmarrësi të mbetet anonim, ose të japë të dhënat e tij të kontaktit, me qëllim që të informohet mbi rezultatet e sondazhit dhe cili prej prioriteteve të komunitetit është marrë parasysh dhe është reflektuar në projekt buxhetin afatmesëm 2022 – 2024.

Nga të dhënat e mbledhura, vërehet se vetëm 7%, ose 5 persona që kanë plotësuar pyetësin kanë dhënë edhe të dhënat e tyre të kontaktit për t'u informuar në vijim me ecurinë e procesit.